



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 1084 / Prot. Datë 24. 02. 2022
 2

Nr. 2060 / Prot. Datë 16 02. 2022
 6

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 29, datë 25 02 2022

“PËR

**PËRCAKTIMIN E RASTEVE, KUSHTEVE DHE MËNYRËS SË MBROJTJES SË
VEÇANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE DHE DREJTUESIT E
INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 20, pika 3, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”,

UDHËZOJNË:

1. Përcaktimin e rasteve, kushteve dhe mënyrën e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve, drejtuesit e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (këtu e në vijim, “Institucioneve”) dhe familjen apo pronën e tyre për shkak të detyrës që mbajnë apo që kanë kryer.

2. Punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit të Institucionit i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pronës, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi kur, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij dhe/ose i familjes, ose prona. Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe punonjësit që nuk e ushtron më detyrën, në rast se e kërkon, në rast cënimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

3. Me mbrojtje të veçantë personale, të familjes dhe të pronës, sipas këtij udhëzimi, do të sigurohet me karakter organizativ e profesional për sigurimin dhe ruatien e veçantë

a) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në prova për rrethana serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë;

b) prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të detyrës, ose ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

5. Pavarësisht mungesës së lidhjes shkakësore të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 4, të këtij udhëzimi, punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i sigurohet mbrojtje e veçantë edhe në rast të pranisë së rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

6. Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet komisionit përkatës me shkrim nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, ministri i Drejtësisë, drejtuesi i Përgjithshëm i Burgjeve, drejtuesi i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtuesi i Institucionit ku punonjësi ushtron detyrën, si dhe çdo organ tjetër publik që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e tij.

7. Kërkesa për mbrojtje të veçantë përmban:

a) gjeneralitetet e plota të kërkuarit;

b) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për punonjësin, të cilat detyrojnë të sigurohet mbrojtje e veçantë;

c) burimin e provave, ku bazohen ato;

ç) llojin e masave që kërkohen dhe kohëzgjatjen e tyre.

8. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet komisionit, sipas rastit, nga subjektet e përcaktuara në pikën 6, të këtij udhëzimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i rrezikohet jeta, familja ose prona.

9. Kur rreziku është serioz dhe i çastit, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa paraprake të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pronën e punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit, deri në mbledhjen e komisionit. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre.

10. Kërkesat për sigurimin e mbrojtjes së veçantë shqyrtohen, sipas rastit, nga Komisioni për Mbrojtjen e Veçantë (në vijim "Komisioni"), i cili ngrihet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, me përbërje si më poshtë vijon:

a) 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, i caktuar nga ministri, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i komisionit;

b) 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, i caktuar nga ministri;

c) 1 (një) përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i caktuar nga drejtuesi i Përgjithshëm i Burgjeve;

ç) 1 (një) përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i caktuar nga drejtuesi i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

11. Anëtarët e Komisionit kanë mandat 2 (dy) vjeçar.

12. Institucionet e përcaktuara në pikën 10 të këtij udhëzimi, caktojnë edhe nga 1 (një) përfaqësues zëvendësues, për të garantuar funksionimin e Komisionit në situata të veçanta.

13. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi caktojnë përfaqësuesit e Komisionit.

14. Kryetari i Komisionit ushtron këto funksione:

a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;

- b) përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët;
- c) siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e Komisionit;
- ç) siguron dokumentimin e mbledhjes së Komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

15. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje, njofton anëtarët e Komisionit për mbajtjen e mbledhjes. Komisioni duhet të mbledhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës.

16. Ministria e Drejtësisë siguron mbështetjen e nevojshme organizative e administrative për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit.

17. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur në të janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga 3 (tre) anëtarë të pranishëm në mbledhje.

18. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, si dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin e funksionimin e organeve kolegjiale.

19. Pjesëmarrja në mbledhjet e Komisionit është e detyrueshme. Kryetari i komisionit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, cakton një sekretar, nga radhët e nëpunësve të Ministrisë, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

20. Komisioni, në procesin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të veçantë të familjes e të pronës, sipas këtij udhëzimi, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera.

21. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet për nevojën e sigurimit të mbrojtjes, shprehet me vendim për të.

22. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personal, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

23. Vendimi i Komisionit i njoftohet punonjësit të Policisë së Burgjeve nëpërmjet drejtuesit të Institucionit ku ushtron detyrën. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit njofton strukturat përgjegjëse për mbrojtjen. Punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit, që nuk e ushtron më detyrën ose që ka dalë në pension, i njoftohet vendimi i Komisionit pranë vendbanimit ose vendqëndrimit të tij.

24. Komisioni, me kërkesë të subjekteve të përcaktuara në pikën 6 të këtij udhëzimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një punonjësi të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i rrezikohet jeta, familja ose prona, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të afatit fillestar.

25. Në rast se rreziku ndaj jetës, familjes ose pronës pushon së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, sipas përcaktimit në vendimin e Komisionit, me kërkesën e çdo subjekti të përcaktuar në pikën 6 të këtij udhëzimi, Komisioni mund të vendosë të ndërpresë mbrojtjen e veçantë.


26. Në rast se punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i shkaktohen dëme për jetën, shëndetin, pronën e tij ose familjes së tij, gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, dëmet shpërblehen nga shteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

27. Ngarkohen Komisioni, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e

28. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË


Ulsi Manja



MINISTRI I BRENDSHËM


Bledar Çuçi

